



“VIRK” S.r.l.

“VIRK Albania” Dega Shqipëri

Adresa: fshati Karinë, Komuna Karinë, ish Reparti Ushtarak – Peqin, Peqin

Nr. _____ Prot

Date ____/____/2017

Lenda: Njoftim për fillimin e procedurave të informimit dhe pjesëmarrjes së publikut për pajisjen me Leje Mjedisi Tipi “A”, të aktivitetit ekzistues Fabrike për prodhimin e fishekzjarreve

Drejtuar: AGJENCISE KOMBETARE TE MJEDISIT
TIRANE

Shoqëria “VIRK Albania” Dege e Shoqërsisë së Huaj “VIRK” S.r.l., është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në datë 06.11.2012, me NUIS: L29706101E. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është: Importi, magazinimi, prodhimi dhe tregtimi i fishekzjarreve.

Shoqëria “VIRK Albania” Dega Shqipëri, ka një kontratë qiraje me pronarin e objektit Ish Reparti Ushtarak Nr.5012, Karinë Peqin., me një sipërfaqe totale trualli prej 15.145 m² në të cilën janë vendosur 10 objekte ndertimore me sipërfaqe totale prej 1553 m². Referuar eksperiencës së fituar nga aktiviteti që shoqëria “VIRK” S.r.l., ushtron në Itali, me Degen e saj në Shqipëri “VIRK Albania”, në këto sipërfaqe dhe këto objekte, shoqëria “VIRK ALBANIA” Dege e Shoqërisë “VIRK” S.r.l., ka hartuar projektin dhe ka ndërtuar një fabrikë të prodhimit të fishekzjarreve.

Për sa më sipër, mbështetur në Ligjin Nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, si dhe në Kreun III, dhe Kreun VI të VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C”, dhe shkresën e AKM Nr.225/1 Prot, datë 10.02.2017, po dergojmë njoftimin për fillimin e procedurës për pajisjen me leje mjedisore Tipi A, për aktivitetin që në parashikojmë të ushtrojmë.

Bashkëlidhur këtij njoftimi do të gjeni:

1. Informacionin në lidhje me kërkesën dhe llojin e Lejes Mjedisore që duhet të pajiset ky aktivitet
2. Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar të leshuar nga QKR
3. Adresën e vendndodhjes së instalimit
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim

5. Autoritetin vendimmarres per dhenien e aktit te miratimit te lejes se mjedisit, procedurat dhe afatet qe do te ndiqen
6. Adresen e Agjencise Kombetare te Mjedisit

Duke pritur vazhdimin e metejshem te procedurave,

Me konsiderate,

Me konsiderate,

Perfaqesues Ligjor

VIRK Albania - Dega Shqiperi

Mirela KRUJA

1. Informacionin ne lidhje me kerkesen dhe llojin e Lejes Mjedisore qe duhet te pajiset ky aktivitet

Referuar Ligjit Nr.10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndyshuar me ligjin Nr.60/2014, shtojca 1,

- INDUSTRIA KIMIKE

4.6. Prodhim i eksplozivëve

Referuar procesit teknologjik te prodhimit fishekzjarreve, kjo veprimtari perfshihet ne pikat 4.6. te Shtojces 1 te ligjit per lejet e mjedisit, i ndyshuar.

Kapaciteti kufi: Referuar ligjit per kete lloj veprimtarie nuk ka kapacitet kufi por aplikohet Leje Mjedisore e Tipit A per te gjitha keto lloj instalimesh.

Sidoqofte, linja e prodhimit te fishekzjarreve ka nje kapacitet prej 100 ton/vit.

Per sa me siper trajtuam, Leja Mjedisore qe duhet pajiset kjo veprimtari duhet te jete LEJE MJEDISORE – Tipi “A”.

2. Te dhena te ekstraktit te leshuar nga QKB

Sipas Ekstraktit te regjistrimit tregtar te leshuar nga QKB, po japim me poshte te dhenat e subjektit:

NUIS:	L29706101E
Data e Rregjistrimit:	06.11.2012
Emri i Subjektit:	VIRK ALBANIA – Degë e Shoqërisë së Huaj
Selia e shoqërisë:	Fshati Karine, Ish Reparti Ushtarak Peqin, Peqin, Qarku Elbasan
Administrator:	Mirela Kruja
Ortakët:	VIRK S.r.l, zoteron 100% te aksioneve (10,000 Euro)
Objekti i aktivitetit:	Fabrikim dhe tregtim me shumice e pakice si ne Itali dhe jashte shtetit, te lojrave piro pirike (fishekzjarre) e piroteknike, fishekzjarre dhe produkte eksplozive, shperthyes te tipit te njejte qe kane marken e depozituar te shoqerise ose te markave te tjera te realizuara nga projekte dhe ose modele te projektimit personal ose te dikujt tjeter.

Bashkelidhur do te gjeni nje kopje origjinale te Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar te Leshuar nga QKB.

3. Adresa e Vendndodhjes se instalimit

Fshati Karine, Ish Reparti Ushtarak Peqin, Peqin, Qarku Elbasan.

4. Pershkrim i veprimtarise qe parashikohet te zhvillohet ne instalim

Perdorimi i fishekzjarreve nga qytetaret shqiptar sidomos ne festa te ndryshme do te kufizohet deri ne nje kategori te caktuar e cila nuk perben rrezik. Qeveria ka menduar qe te beje disa ndryshime ne ligjin Per perdorimin civil te lendeve plasese ne Republiken e Shqiperise i cili parashikon lejimin e nje kategorie te caktuar lendesh piroteknike ne duart e qytetareve. Kjo gje synon qe te eliminoje jovetem rreziqet ndaj popullise civile nga lenen plasese te pakontrolluara por do te reduktoje edhe ndotjen akustike qe shoqeron qytetet shqiptare sidomos gjate festave te fundvitit nga fishekzjarret dhe lendet e tjera plasese me fuqi te larte. Ndryshimet qe perfshin ligji pervec rregullimeve per perdorimin e lendeve plasese perfshijne edhe lendet piroteknike dhe fishekzjarret.

Dispozitat e ketij ligji qe ndryshojne rregullojne prodhimin importin eksportin dhe magazinimin e lendeve plasese per perdorim civil por ato do te zbatohen edhe per prodhimin importin eksportin dhe magazinimin e lendeve piroteknike dhe fishekzjarreve. Por nuk zbatohen per lendet piroteknike dhe fishekzjarret dispozitat e ketij ligji per regjistrimin gjurmimin transferimin dhe perdorimin e lendeve plasese per perdorim civil.

3.3. Pozicioni gjeografik

Fabrika e fishekzjarreve qe parashikohet te ngrihet ndodhet ne njeh distancë ajrore 1.2km ne zonën perëndimore jashtë qytetit të Peqinit ose 2km nga qendra e qytetit. Zona qe zeh fabrika ka njeh sipërfaqe totale prej 15156 m² dhe lidhet me rrugën kryesore me aneh të njeh rruge betoni me njeh gjatësi prej 400 metrash, dhe gjerësi 4m. Ne aneh jugore gjendet njeh linjeh hekurudhore ne njeh distancë ajrore 103m. Fabrika është e pozicionuar ne luginë dhe me gjelberim rreth e qark dhe mes kodrave qe e rrethojnë.



Pamje e zonës së fabrikës.

Zona është tërësisht e izoluar dhe ndodhet larg vendeve që frekuentohen nga njerëzit si edhe nga çdo ndërtesë e banuar. Terreni është kodrinor dhe pjesërisht fushor dhe të gjitha ndërtesat ndodhen në atë fushor.




Pamje ajrore e pozicionit të fabrikës nga qyteti dhe rrethinat e saj.

3.4. Shkurt rreth procesit të prodhimit të fishekzjarreve në fabrike

Siç edhe e kemi theksuar në fillim të këtij vleresimi, objekt i aktivitetit të propozuar nga shoqëria “VIRK Albania” është ndërtimi i një fabrike për prodhimin e fishekzjarreve për përdorim civil.

Propozimi është i lidhur ngushtë edhe me pozicionin e pershtatshme dhe infrastrukturene që zoteron ish reparti ushtarak Nr.5012 në fshatin Karine, Peqin.

Me pashtë po bëjmë një përshkrim të procedeve të punës që parashikohet të ketë në këtë fabrike të prodhimit të fishekzjarreve.



Planimetria e vendosjes se objekteve te fabrikes sipas menyres se funksionimit te procesit te prodhimit

3.4.1 Procesi i prodhimit te fishekzjarreve cilindrikë, sferikë dhe mortaja profesionale

Faza e parë

Nga magazina e produkteve kimike (3 ose 13) merren disa produkte për tu transferuar në ambientin e përzjerjes-apo magazinimit ditor (8C). Nga magazina e lëndës së parë (3), do të zgjidhen dhe do të transferohen si në repartin e presave (5) ashtu edhe në repartet e laboratorëve (4, 6 e 7), kontenitorët e ndryshëm prej kartoni për t'u përdorur në varësi të tipit të punës.

Faza e dytë

Në repartin e përzierjes (8A e 8C) prodhimet kimike, që mbërrijnë në formë pluhuri të imët, ndahen, peshohen, unifikohen dhe siten, me qëllim përfitim të efektit të dëshiruar dhe hidhen menjëherë në kontenitorët e posaçëm për t'u transferuar në repartin ngjyrat (11). Njëkohësisht në repartin e presave kryhet një fazë përpunimi si me makineri ashtu edhe me dorë, me qëllim përfitim të produkteve gjysëm të përgatitura, që do të bashkohen së bashku në një fazë të dytë në repartet e laboratorëve.

Faza e tretë

Në repartin e ngjyrave përbërjet ngjyrosëse, vendosen manualisht dhe nën kontroll të rreptë, në makineritë e posaçme “stars machine”, të cilat duke kryer një lëvizje rrotulluese, shndërrojnë pluhurin në toptha të vegjël, të cilat quhen të përfunduara pas arritjes së diametrit të përfunduar. Këto punime do të mbyllën me nxjerrjen e “ngjyrave” nga makineritë, për t'u dërguar menjëherë në repartin e tharjes (9A), ku do të vendosen në tava të posaçme në pritje të tharjes së tyre. Tharja e tyre mund të kryhet edhe në ambiente të hapura, në një zonë të fabrikës që do të zgjidhet për këtë qëllim. Pasi të jenë tharë, ngjyrat do të kalojnë në repartin e tharjes (9B) dhe do të vendosen në kontenitorë në pritje që të merren për t'u përpunuar.

Faza e katërt

Kjo fazë e fundit ndodh në repartet e laboratorëve dhe konsiston në bashkimin e të gjithë produkteve gjysëm të gatshme, të prodhuara në repartet e ndryshëm, me një sekuençë pune të vazhdueshme që parashikon, fazën e ngarkesës, fiksimit dhe ngjitjes, që përmbyllet me ambalazhimin e produkteve të përfunduara. Produktet e përfunduara katalogohen menjëherë dhe dërgohen në magazinën e produkteve të mbaruara, në pritje që të tërhiqen për shitje. Ky proces prodhimi nuk shoqërohet nga shkarkime ujrash në ambiente të hapura dhe nuk prodhon mbeturina.

3.4.2 Përshkrimi i produkteve përfundimtare.

Fishekzjarre cilindrike

Artikulli piroteknik, përbëhet nga një tub kartoni të presuar, i kalibrave të ndryshëm, i mbyllur në të dy skajet e tij me tapa kartoni. Në pjesën e poshtme të artikullit është vendosur ngarkesa shtytëse (barut), e lidhur me kapsulën që i lejon artikullit, që pasi të ndizet nëpërmjet një fitili, të ketë kohën e nevojshme që të arrijnë në lartësinë e programuar dhe të hapet nëpërmjet një ngarkese “çarëse”, e cila shkakton shpërthimin e përbërësve gjysëm të përgatitur dhe që ndodhen në cilindër, duke bërë që ata të japin efektin e goditjeve dhe të ngjyrave.

Fishekzjarret sferike

Artikulli piroteknik, përbëhet nga një zhguall të presuar kartoni ose plastik, të kalibrave të ndryshëm. Në bazën e çdo sferë është mbyllur ngarkesa shtytëse që përbëhet nga barut. Në

pjesën e poshtme të artikullit është vendosur ngarkesa shtytëse(barut), e lidhur me kapsulën që i lejon artikullit, që pasi të ndizet nëpërmjet një fitili, të ketë kohën e nevojshme që të arrijnë në lartësinë e programuar dhe të hapet nëpërmjet një ngarkese “çarëse”, e cila shkakton shpërthimin e përbërësve gjysëm të përgatitur dhe që ndodhen në zhguall, duke bërë që ata të japin efektin e shndritjeve dhe të ngjyrave.

Tubat plasës

Artikulli piroteknik, përbëhet nga një tub lëshimi, prej kartoni, i kalibrave dhe i dimensioneve të ndryshme. Tubi, në pjesën e poshtme, është mbyllur nga një tapë mbi të cilën është vendosur një ngarkesë shtytëse(barut), shtytja e së cilës shkakton lëshimin e fishekzjarreve të përbërë nga përzierje të ndryshme piroteknike, që gjatë shpërthimit prodhojnë efekte të ndryshme.

Emrat e produkteve (të kalibrave të ndryshëm):

- *Vpc 75*
- *Vpc 10*
- *Butterfly peony*
- *Whistle peony*
- *Colours Peony (Red, Green,Blue,Purple, Orange, Aqua)*
- *Yellow glitter*
- *White glitter*
- *Crys to red*
- *Crys to blue*
- *Colours Wawe (Red, Green,Blue,Purple, Orange, Lemon, Yellow)*
- *12 Rendine giorno*
- *Colpi oscuri*
- *Peonia controcolpo (Spacco e botta)*
- *Stutata*
- *Fermata*

Emrat e produkteve (të kalibrave të ndryshëm) te fishekzjarreve sferike

- *VPS 75*
- *VPS 10*
- *VPS 12*
- *VPS 15*
- *Display shells 5 – 6,5 – 7,5 c- 10 – 12,5 – 15 – 17,5 – 20 – 25 – 30 – 40*

3.4.3 Procesi i prodhimit të kapsollave dhe koneve

Faza e parë

Nga magazina e lëndëve inerte (3) merren disa produkte për tu transferuar në repartin e presave (5) . Nga magazina e produkteve kimike (3 ose 13) merren disa substanza që transferohen në repartin e përzierjes(8).

Faza e dytë

Në repartin e përzierjes, lëndët kimike ndahen në doza dhe përzihen manualisht me njëra-tjetrën, duke përgatitur një përzierje që transferohet në repartin e presave

Faza e tretë

Në repartin e presave, kryhen në mënyrë manuale ose me makineri, një sërë veprimesh zinxhir, që konsistojnë në pozicionimin e mbështjelljeve me formë cilindrike ose konike, me dimensione të programuara, në kontenitorë të posaçëm prej bakeliti. Më pas kryhet vendosja e pluhujve dhe përzierjeve të ndryshme në mbështjelljet e përmendura, deri sa të mbërrijmë në mbylljen e fishekzjarrit, e cila kryhet me tapa plastike ose kartoni, në njërin krah, ndërsa në tjetrin vendoset fitili ndezës, i cili është përgatitur më parë. Fishekzjarret vendosen në tufëza, në kutitë përkatëse dhe vendosen në një vend të parapërcaktuar, në pritje që ata të thahen.

Faza e katërt

Në repartin e presave nëpërmjet veprimeve manuale, fishekzjarret që ndërkohë janë tharë, merren dhe vendosen në kutiçka, të cilat me rradhë vendosen në kuti kartoni. Kutitë e kartonit katalogohen dhe dërgohen menjëherë në magazinën e produkteve të përfunduara (14) në pritje të shitjes së tyre. Ky proces prodhimi nuk shoqërohet nga shkarkime ujrash në ambjente të hapura dhe nuk prodhon mbeturina.

3.4.4 Përshkrimi i produktit final

Kapsollat

Artikulli piroteknik përbëhet nga një tubet prej kartoni, të kalibrave dhe dimensioneve të ndryshme. Ndezja kryhet nëpërmjet një përzierje ose fitili të vendosur në njërin skaj, ndërsa skaji tjetër është i mbyllur me një tapë plastike. Poshtë sistemit të ndezjes ndodhet një ngarkesë vonese, e cila është parashikuar për arsye sigurie dhe pasohet nga përzierja që përcakton efektin e produktit ose shpërthimin e tij. Emrat e produkteve: Raudi tipo C1, Pirato, Zeus, Tuono tipo c, Super tuono, Mirage tipo c, Patriot, Super Patriot, Graudi, Giove, Boom, Rendine, Bengala 1,2,3 etj.

Konet

Artikulli piroteknikë, përbëhet nga një tub kartoni me formë konike, që e ka bazën më të gjerë dhe skajin e lartëm më të ngushtë. Ndezja kryhet nëpërmjet një fitili, të vendosur në skajin e sipërm, e i cili mbahet në vend nga një pastë pluhuri. Baza mbyllet me dy disqe prej kartoni.

3.5 Lenda e pare dhe ndihmese te procesit te prodhimit

Te gjitha lendet e para te domosdoshme per ciklin e prodhimit dhe ne vecanti produktet kimike, ne fazen fillestare, do te blihen ne Itali dhe do te transportohen ne Shqiperi. Per pasoje, me qellim optimizimin e cmimeve, disa nga keto lende do te vijne nga kontinente te tjera ose do te gjenden direkt ne Shqiperi.

Ne fabrike, per prodhim, do te perdoren substancat e meposhtme kimike:

- *Alumin (i llojit te ndryshem)*
- *Trisulfid Antimoni*
- *Karbonat Kalciumi*
- *Karbonat Stronciumi*
- *Qymyr Druri (i llojit te ndyshem)*
- *Kriolit*
- *Ngjitese pluhur e verdhe*
- *Gome Akaroid*
- *Gome Arabike*
- *Magal*
- *Magnez*
- *Nitrat Bariumi*
- *Nitrat Potasiumi (i llojit te ndryshem)*
- *Nitrat Stronciumi*
- *Oksalate Natriumi*
- *Oksid Bakri i zi*
- *Perklorat Potasiumi*
- *Silic Pluhur*
- *Tape (i llojit te ndyshem)*
- *Gjitese PVC*
- *Sulfur*

Emrat e produkteve (të kalibrave të ndryshëm) te tubove plases:

- *Sbruffo*
- *Striscione*
- *Sbruffo e striscione*
- *Monogetto Apertura*

5. Permbledhje jo-teknike te Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ne nivel kombetare ose nderkombetar kur kerkohet procedura e VNM-es.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, referuar dhe aktivitetit dhe natyres se veprimtarise se propozuar si dhe pershkrimet:

Shtojca 1: veprimtaria qe ne propozojme perfshihet ne piken 6- Instalime te integruara kimike, domethene instalime per prodhimin ne shkalle industriale te substancave qe perdorin procesete shnderrimit kimik, ku shume njesi jane vendosur perballe njera tjetres dhe jane te lidhur funksionalisht me njera tjetren per: dh) per prodhimin e eksploziveve

Por, theksojme qe ky eshte nje instalim ekzistuese dhe qe eshte ne funksionim, pra nuk eshte nje instalim i ri. Ne keto kushte, nuk eshte nen juridiksionin e ligjit per VNM.

Siç edhe dime Lejet e mjedisit lidhen së pari me operimin e instalimeve dhe kanë fokusim më të ngushtë – kryesisht ndotja mjedisore – shkarkimet në ajër, shkarkimet, mbetjet etj. Qëllimi i aplikimit të lejes së mjedisit është t'i sigurojë autoritetit kompetent informacion duke demonstruar që instalimi i propozuar do të operojë për të reduktuar ndotjen duke përdorur TMD. Leja e mjedisit jepet vetëm kur është rasti. Te lejet e mjedisit, ndikimet mjedisore nuk janë të balancuara përkundrejt kostove të tjera dhe përfitimeve në vendim marrjen.

Ne konkluzion, veprimtaria e propozuar e prodhimit të fishekzjarreve nuk kërkon hartimin e Raportit të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, mbështetur edhe në shkresën Nr.225/1, datë 10.02.2017 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM)

6. Konsultime nderkufitare kur kerkohen sipas legjislacionit ne fuqi

Projekti i propozuar nuk zhvillohet ne zone nderkufitare, ndaj dhe nuk i nenshtrohet konsultimeve nderkufitare.

7. Autoriteti vendimmarres per dhenien e aktit te miratimit te lejes se mjedisit, procedurat dhe afatet qe do te ndiqen

Referuar percaktimit te bere ne piken 1 te kesaj kerkese dhe mbeshtetur ne Ligjin Nr.10488, date 14.07.2011 "Per lejet e Mjedisit", percaktuam llojin e lejes mjedisore: Leje Mjedisore tipi B.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.10488, date 14.07.2011, nenin 4 – Sistemi i lejeve te mjedisit, pika 1-b, percakton: leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

pika 2, percakton:

Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C janë si më poshtë:

a) Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) është autoriteti ku bëhet kërkesa dhe ku lëshohet leja e mjedisit të tipit A, B dhe C;

b) Ministri është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKB-ja;

Ne lidhje me procedurat dhe afatet për marrjen e lejes së tipit "A", duhet t'i referohemi VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C".

VKM Nr.419, datë 25.06.2014, Kreu III, – Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe

percaktimi i kushteve per leje mjedisi te tipit B percakton proceduren si me poshte:

KREU II

1. Kërkuesi që aplikon pranë QKB-së për pajisjen me leje mjedisi të tipit A duhet të dorëzojë këto dokumente:

- a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit A, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit A, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;
- ç) Kopjen e vendimit të AKM-së për VNM-në paraprake ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas percaktimit në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
- d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.
- dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas percaktimit në pikën 13 të kreut VI të këtij vendimi.

2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit B nga QKLja, dërgon një kopje të aplikimit në institucionet e mëposhtme, të cilët japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune:

- a) Drejtoritë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit;
- b) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU);
- c) Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM).

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, nuk shprehën brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën.

4. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit B dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit B, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri.

5. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes, firmos aktin e miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit B ose ia kthen praktikën AKM-së për shtesa apo ndryshime të këtij akti, të shoqëruar me argumentet përkatëse.

6. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon vendimin e miratimit ose të refuzimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve për leje mjedisi të tipit A.

Refereuar pikes 1, dh) te ketij kreu – per te bere te mundur aplikimin per leje mjedisi ne QKL, kerkohet te hartohet relacioni per degjese me publikun sipas percaktimeve te bere ne piken 13, Kreun VI i ketij vendimi:

13. Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjësës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKL.

Kreu VI i ketij vendimi, percakton procedurat e indormimit dhe pjesmarres se publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B, si me pohste vijon:

1. Kërkuesi, përpara aplikimit në QKL, dërgon në AKM, në njësinë e qeverisjes vendore (NJQV) dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM) ku do të ketë vendndodhjen instalimi një njoftim, me shkrim dhe në formë elektronike (CD, DVD), për aplikimin që do të kryejë për t'u pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B, në të paktën 20 kopje elektronike për secilin institucion.
2. Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

- a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”.
 - b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
 - c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
 - ç) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
 - d) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
 - dh) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
 - e) Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
 - ë) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
 - f) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.
3. AKM-ja publikon, në faqen e saj të internetit, njoftimin sipas pikës 2 të këtij kreu, për të paktën 20 (njëzet) ditë kalendarike, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.
 4. Pas publikimit të njoftimit në faqen e internetit të AKM-së, kërkuesi publikon në, të paktën, një gazetë të zonës ku do të ushtrohet veprimtaria dhe në një gazetë kombëtare njoftimin për aplikimin, duke iu referuar për informacion më të hollësishëm faqes së internetit të AKM-së. Njoftimi publikohet në, të paktën, dy numra të njëpasnjëshëm të secilës gazetë.
 5. Njoftimi në gazetë duhet të përmbajë, të paktën:
 - a) llojin e instalimit/veprimtarisë;
 - b) emrin e personit fizik/juridik;
 - c) adresën e vendndodhjes së instalimit;
 - ç) adresën e internetit ku është publikuar njoftimi dhe adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.
 6. NJQV-ja (bashkia apo komuna), në territorin e së cilës do të jetë vendndodhja e instalimit, pasi merr njoftimin sipas pikës 2, të këtij kreu, e publikon në një vend të dukshëm në mjediset e saj për të paktën 20 (njëzet) ditë.
 7. Publiku ka të drejtë të konsultojë në mjediset e NJQV/AKM/ARM dhe të kërkojë një kopje të njoftimit, sipas pikës 2, të këtij kreu, nga NJQV/AKM/ARM, pa pagesë.
 8. Publiku mund të bëjë komente, me shkrim ose në mënyrë elektronike, mbi njoftimin për leje mjedisi të tipit A në adresën e AKM-së brenda afatit 20-ditor të publikimit.
 9. Në përfundim të afatit 20-ditor, kërkuesi, në bashkëpunim me AKM-në dhe NJQV-në, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve organizon një dëgjësë me publikun dhe palët e interesuara, përfshirë OJF-të.
 10. Njoftimi për dëgjësën me publikun shpallet gjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve:
 - a) në radio ose TV dhe gazetën vendore;
 - b) në faqen e internetit të AKM-së dhe NJQV-së;
 - c) në tabelën e njoftimeve, në një vend të dukshëm në mjediset e NJQV-së dhe ARM-së së qarkut përkatës.
 11. Njoftimi duhet të shoqërohet me:
 - a) llojin e instalimit/veprimtarisë;
 - b) emrin e personit fizik/juridik;
 - c) adresën e vendndodhjes së instalimit;
 - ç) vendin ku gjendet kopja e njoftimit në NJQV-në dhe adresën elektronike të AKM-së ku është publikuar njoftimi.
 - dh) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të dëgjësës me publikun.
 12. Procesverbali i dëgjësës mbahet nga kërkuesi dhe nënshkruhet nga pjesëmarrësit në dëgjësë. Kopje të procesverbalit u vihen në dispozicion publikut, palëve pjesëmarrës në dëgjësë, NJQV-së dhe AKM-së.
 13. Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjësës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKL.
 14. Shpenzimet e organizimit të dëgjësës mbulohen nga kërkuesi.
 15. AKM-ja, gjatë hartimit të aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A dhe B, merr parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku që vlerësohet i vlefshëm dhe argumenton arsyet kur ato nuk janë marrë parasysh.

16. AKM-ja, kur e gjykon të arsyeshme, delegon ARM-në e qarkut përkatës për të marrë pjesë në dëgjuesën me publikun.

Ne kuader të kësaj kerkese të sipërcituar kemi filluar këtë procedurë të informimit dhe konsultimit me publikun për veprimtarinë e propozuar të prodhimit të pelletit.

8. Adresën e AKM-es ku publiku mund të dergojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 ditëve nga data e njoftimit.

Autoriteti shtetëror ku mund të dergohen komentet dhe sugjerimet për sa përshkruhet në këtë kerkese për informim dhe konsultim të publikut është:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)

Adresa: Rr. "Sami Frasheri", Nr.4, Tiranë

Tel & Fax: 04 2 371 237

www.akm.gov.al

e-mail: info@akm.gov.al

Kerkuesi,

VIRK ALBANIA – Dege e Shoqërisë së huaj

Mirela KRUIJA

Perfaqësues Ligjor